



Datë: 12.11.2025
Numër Protokolli: 7465/2025

A.nr.1261/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1261/2025, të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesi Y.S, kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1261/2025, e datës 01.07.2025, e parashtruar nga ankuesi, Y.S.

II. Mbetet në fuqi Akt-Njoftimi Nr.100/2025, i datës 05.06.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimit më numër reference RN00016992.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, Y.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 01.07.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016992, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit*, të shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4443/2025, të datës 01.07.2025 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit;

Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 28.07.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Ftesën për test me shkrim të datës 12.05.2025; Ftesën për intervistë me gojë të datës 02.06.2025; Kërkesën e datës 06.03.2025; Konkursin me numër reference RN00016992; Listën e aplikantëve; Listën e kandidatëve të aprovuar; Vendimin Nr.2/1754, të datës 06.05.2025; Akt emërimit Nr.55/2024, të datës 05.09.2024; Akt emërimit Nr.96/2024, të datës 06.09.2025; Akt emërimit Nr. 29/2025, të datës 05.09.2024; Akt emërimit Nr.52/2024, të datës 05.09.2024; Vendimin Nr.2/1234 të datës 01.04.2025; Vendimin V.nr.65/2025 të datës 06.05.2025; Aktit të Emërimit nr.130/2024, të datës 01/10/2024, Formularin e përshkrimit të detyrave të punës; Çelësin e pyetjeve për Intervistë; Formularin e vlerësimit individual e anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë; Njoftimin përfundimtar Nr.100/2025, të datës 05.06.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 03.04.2025, i kandidatit Y.S, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 03.04.2025, i kandidatës Xh.B-B, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Testin me shkrim të datës 22.05.2025, i kandidatit Y.S; Vendimin me Nr.prot. 5492/2025, i Kryetarit të Këshillit; Rikujtimin e kërkesës për përcjelljen e provave të munguara (E-mailin e datës 16.09.2025); E-mailin e datës (17.09.2025) së bashku me provat e munguara: Renditja përfundimtare nga SIMBNJ.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të pabazuara, **sepse:**

Gjendja e çështjes:

-Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 07.03.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00016992, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit*, në Departamentin Ligjor, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, një (1) vend i lirë pune, me mandat katër (4) vjeçar, i hapur për aplikim nga data 08.03.2025 deri më datën 06.04.2025.

-Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej dhjetë (10) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim është vlerësuar me 60 pikë, ndërsa, në intervistën me gojë 18 pikë, gjithsej 78 pikë.

-Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit më datë 07.03.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues nga i cili njoftim rezulton se si kandidate e suksesshme për procedurën përkatëse të rekrutimit është shpallur Xh.B-B me gjithsej 95 pikë.

Pretendimet ankimore:

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke atakuar ligjshmërinë e procedurës me numër reference RN00016992, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, si dhe shkeljes së rregullores për pranim në shërbimin civil, mbi pretendimet ankimore se testi me shkrim është dashur të mbahet brenda afatit prej 15 ditësh, ndërsa, Komisioni i pranimit ka shtyrë afatin për vlerësim nëpërmjet testit me shkrim në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2023 dhe se ligji i procedurës administrative nuk aplikohet në procedurat e pranimit në shërbim civil. Tutje, shton se rezultatet e testit me shkrim dhe as lista me rezultatet e intervistës me gojë nuk janë publikuar, pyetjet e intervistës me gojë kanë qenë tendencioze, sugjestive dhe përcilleshin më nën pyetje dhe vetëm dy nga pyetjet ishin profesionale, ndërsa, pyetjet tjera nuk kishin të bënin me pozitën e shpallur. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj konkursin në tërësi si rezultat i shkeljeve procedurale nga ana e Komisionit të Pranimit.

Vlerësimi i Kolegjit:

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e kontestuar, e në këtë aspekt, kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit numër reference RN00016992, dhe si rrjedhojë ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushën: Juridik, Ekonomik, Psikologji, Administratë Publike, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.**

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 9: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtarëve/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrit të përgjegjës për administratë publike.*

-Nenit 44 :1. *Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në uebfaqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është njëqind (100) pikë.*

-Nenit 45: 1. *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës/ës civil nga njësi përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë. 3. Komisioni i pranimi zgjidhet adhoc për çdo pozitë nga lista e kandidateve/ë*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- Nenin 7: Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

-Nenin 8: Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimi me mbështetjen e NjMBNj.

-Neni 9: Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNj. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenin 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese

bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimiit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

-Nenin 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimiit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Si rrjedhojë, referuar kuadrin ligjor si më sipër Kolegji konstaton së kriteret e përgjithshme formale kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën përkatëse.

Komisioni i Pranimiit i themeluar sipas Vendimit Nr. 2/1754, të datës 06.05.2025, të Sekretares së Përgjithshme të MASHT-it, ka qenë në përbërje: 1.N.S, në cilësi të kryesuesit, N.M, zëvendësuese; 2. R.P, anëtare, B.G, zëvendësues; 3. Q.S, anëtare, Xh.B, zëvendësues; 4.F.B, anëtare, V.F-M, zëvendësuese; 5. B.H-K, anëtare, A.K, zëvendësuese.

Rrjedhimisht, bazuar në formularët e vlerësimit, konstatohet së vlerësimi i kandidatëve në këtë procedurë është bërë në përbërje nga N.S, i cili sipas aktit të emërimit nr.22/2024, të datës 05.09.2024, ushtron pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Arsim të Komuniteteve, Q.S, e cila sipas aktit të emërimit nr.96/2024, të datës 06.09.2024, ushtron pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Programeve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në Arsimin e Lartë dhe Shkencë; V.F-M, e cila sipas aktit të emërimit nr.29/2024, të datës 05.09.2025, ushtron pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Cilësi, Standarde dhe Korrikula të Arsimit dhe Aftësimiit Profesional, B.H-K, sipas Aktit të Emërimit nr.130/2024, të datës 01/10/2024, ushtron pozitën e Zyrtares së Lartë par Rekrutim dhe Paga në Divizionin e Burimeve Njerëzore dhe R.P, e cila sipas Vendimit nr.2/1234, të datës 01.04.2025, ushtron pozitën u.d Udhëheqësit të Divizionit për Monitorimin e Kontratave dhe Punës Nder-sektoriale. Pra, mbi gjendjen e këtyre dëshmime materiale, përbërja e Komisionit të Pranimiit është në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuar me nenin 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Lidhur me pretendimet ankimore përkitazi me testin me shkrim, Kolegji i Këshillit ka analizuar testin me shkrim të aplikuar për pozitën e kontestuar, dhe si rrjedhojë ka gjetur së testi përmbante 25 pyetje me shumë opsione të tipit të kombinuar, me pyetje të përgjithshme dhe me pyetje që ndërlidhen me vendin e punës, dhe po ashtu tema e eses në vlerësimin e kolegjit ndërlidhen me pozitën e shpallur, pra pyetjet e testit kanë qenë përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil, Rrjedhimisht, ankuesi ka dhënë 23 përgjigje të sakta tek pyetjet me shumë opsione, duke grumbulluar 46 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), vlerësim ky qe behët nga sistemi elektronik, ndërsa, në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimiit, ankuesi është vlerësuar më 16 pikë, nga 20 pikët maksimale. Në fakt, mbi këto rrethana Kolegji nuk verën vlerësim jo të drejtë apo diskriminues të ankuesit në këtë fazë të vlerësimit.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor lidhur me shtyrje të afatit të mbajtjes së testit më shkrim, nuk gjen mbështetje ligjore, mbi faktin se dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) vijnë në shprehje në çdo procedurë administrative që zhvillohet pranë organit publik dhe me theks të veçantë çdo herë kur ligji i veçantë nuk rregullon një çështje të caktuar. Mbi këtë përcaktim ligjor, rrjedhë fakti së meqenëse Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nuk përmban rregulla lidhur me shtyrje të afateve në procedurë të pranimit në shërbim civil, atëherë, në rastin e tillë *de jure* vije në shprehje aplikimi i dispozitave të LPPA-së, e mbi këtë bazë kishte vepruar edhe MASHTI me rastin e nxjerrjes së Vendimit V.nr.65/2025, të datës 06.05.2025, për shtyrje të afatit për 15 ditë lidhur me mbajtjen e testit më shkrim, duke u bazuar në nenin 99.1 të LPPA-së.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor përkitazi më pyetjet e intervistës me gojë, Kolegji nga shqyrtimi i provave materiale të çështjes ka konstatuar së pyetjet e parashtruar në intervistë kanë qenë: 1. Kur fillon të prodhojë pasoja juridike një akt administrativ?, Si menaxhoni afatet dhe prioritet?, 3. A keni pasur ndonjëherë konflikt në punës dhe si i keni menaxhuar?, 4. Si veproni nëse ju kërkohet të ndërmerri një vendim i cili nuk është në kompetencën e juaj? dhe 5. Në cilat parime bazohet pranimi në detyrë i një zyrtari publik. Në vlerësimin e kolegjit, pyetjet në intervistë më gojë i referohen njohurive të pozitës së kontestuar dhe njohurive menaxheriale, nuk janë të natyrës tendencioze apo sugjestive dhe se parashtrimi i nën pyetjeve nga anëtarët e Komisionit nuk përbën shkelje ligjore, pasi që nën pyetjet parashtrohen më qëllim të sqarimit edhe më të plotë të përgjigjes, kështu që pretendimet ankimore mbi këtë bazë nuk janë të pranueshme ligjorisht.

Referuar pretendimit për mos publikim të rezultateve të testit më shkrim dhe intervistës me gojë, Kolegji thekson faktin së i gjithë procesi i rekrutimit në shërbim civil zhvillohet përmes platformës elektronike SIMBNJ, në atë mënyrë që komunikimet dhe shkresat që dalin nga procedua e pranimit përcillen përmes kësaj platforme individualisht në profilet personale të kandidateve, përshtirë rezultatet e testit më shkrim dhe rezultatet e intervistës me gojë dhe së njoftimi i shpalljes së kandidatit fitues është publik në SIMNJ për çdo kandidatë.

Në kuptim të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidates Xh.B-B (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), dhe si pasojë ka gjetur se e njëjta posedon: Diplomën Nr.2482, të datës 12.03.2014, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “*Hasan Prishtina*”, për përfundimin e studimeve themelore më datë 13.12.2012, në Fakultetin Juridik, si dhe Diplomën Nr.2525, të datës 22.02.2021, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “*Hasan Prishtina*”, për përfundimin e studimeve master në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative. Lidhur më përvojën e punës pas diplomimit kandidatja ka bashkangjitur Vërtetimin Nr.ref.30/2025, të datës 04.04.2025, të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me të cilin dëshmohet se kandidatja Xh.B është në marrëdhënie punë pranë kësaj ministrie që nga data 15.08.2013, dhe atë në pozitë: Asistente Ekzekutive në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, nga data 15.08.2013 deri 14.11.2018; Zyrtare e Lartë Ekzekutive në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm nga data 14.11.2018 deri 04.11.2024, dhe nga kjo datë e fundit e njëjta është caktuar u.d e Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Legjislacionit, Mbështetje Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Pra, mbi gjendjen e këtyre dëshmive rrjedhë së kandidatja e shpallur fituese ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë së e njëjta në fazën e vlerësimit ka arritur gjithsej 95 pikë të përgjithshme, duke u renditur si kandidatja me më së shumti pikë të mbledhura, atëherë, e njëjta konsiderohet edhe si kandidate e suksesshme për këtë procedurë të pranimit, kështu që, mbi këtë bazë njësia përgjegjëse në MASHT ka vepruar pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me rastin e shpalljes si kandidat fitues.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se procedura për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit* është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1261/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Y.S;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.